



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.115/2017

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP)**, në panelin e përbërë nga anëtarët: Rafet Haxhaj kryesues, Gyltene Sylejmani dhe Afijete Sada-Gllogjani anëtarë, me pjesëmarrjen e Zyrtares së Lart Ligjore Antigona Murati, duke vendosur përkritazi me ankesën e Partisë Demokratik te Kosovës (PDK) me seli në Mitrovicë, paraqitur kundër subjektit politik Vetëvendosje (VV), me seli në Prishtinë, për shkak të nxitjes së urrejtjes, gjatë fushatës zgjedhore për Zgjedhjet Lokale që do të mbahen me datë 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur, me datë 06.10.2017, mori këtë:

## V E N D I M

**REFUZOHET** si e pabazuar ankesa e Partisë Demokratik te Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, e cila identifikohet me shenjën ZL.Anr.115/2017, e datës 02.10.2017, me të cilën ka kërkuar që të ndërmerren veprimet ligjore kundër subjektit politik Vetëvendosje (VV), me seli në Prishtinë, për shkak të nxitjes së urrejtjes gjatë fushatës zgjedhore.

## A r s y e t i m

Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Mitrovicë, ka parashtruar ankesë në PZAP, me datë 02.10.2017, me të cilën pretendon se me datë 28.09.2017, nga ora 18:00 të mbrëmjes, në Qendrën e Kulturës “Rexhep Mitrovica” në Mitrovicë në tubimin elektorale të Partisë Lëvizja Vetëvendosje, kryetari i kësaj partie Visar Ymeri në fjalimin e tij ka vepruar në kundërshtim me nenin 33.par 1 Pika I të LZP-së Pretenduesi i ankesës në vazhdim ka theksuar se i njëjti në fjalimin e tij në gjuhën e përdorur e ka krahasuar Kryetarin e Partisë Demokratike të Kosovës, Z. Kadri Veseli, me një person të quajtur Zharko Veselinovic i cili tek qytetarët e Mitrovicës njihet si person me procedurë penale. Parashtruesi i ankesës potencon se krahasimi i bërë është i papranueshëm dhe veprim tejet i ulët dhe provokues për të gjithë anëtarët dhe simpatizantët e subjektit politik PDK. Me propozim për panelin që të ndërmerren masa ligjore ndaj zyrtarit të caktuar në fjalë.

Subjekti politik Vetëvendosje (VV), në përgjigje në ankesë të datës 03.10.2017, thekson se fjalimi i kryetarit të Lëvizjes Vetëvendosje në tërsi ka qenë në kornizat e fushatës së lejuar e cila si qëllim ka pasur përhapjen e porosive politike, duke përfituar përkrahjen sa më të madhe votuesve në zgjedhjet lokale të 22 tetorit. Në vazhdim të përgjigjes thekson se në periudhën e fushatës zgjedhore organizimi i tubimeve publike ka për qëllim edhe shpалosjen e platformave politike të subjekteve politike si edhe kritikën që mund të adresohen pushtetit të


kaluar dhe aktual në lidhje mos punën e bërë gjatë mandateve qeverisëse. Fjalimi i tillë ka qenë i drejtuar në këto dy drejtime dhe për këtë arsye kategorikisht duhet të përjashtohet nga një sanksionim i tillë. Përmbajtja e fjalimit të mbajtur, nuk i përmbush elementet që nxitë dhunë, urrejtje dhe fjalimi i tijë nuk ka reflektuar ndjenjë të armiqësisë ndaj kryetarit të PDK-së. Deklarimet e tilla duhen të jenë të interpretushme në suaza të lirisë së shprehjes si e drejtë themelore e sanksionuar me Nenin 40 të Kushtetutës dhe të jetë interpretuar në pajtim me Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut, siç zbatohet në praktikat ligjore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Me propozim për panelin që ankesa të refuzohet si e pabazuar.

Pretendimet ankimore të parashtruesit të ankesës lidhur me shkeljen e pretenduar të Kodit të Mirësjelljes nga ana e subjektit politik Vetëvendosje, Paneli i vlerësoj se janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se veprimet e përshkruara në ankesë nuk paraqesin shkelje të Kodit të Mirësjelljes në kuptim të dispozitës së nenit 33 par 1 pika I të LZP-së b) të LZP-së, për arsye se shkeljet e pretenduara në ankesë nuk ka të bëjë me nxitje të urrejtjes në fushatën zgjedhore të zgjedhjeve lokale 2017. Me këtë rast paneli konsideron, se parashtruesi i ankesës, me dëshmitë e ofruara nuk i ka vërtetuar pretendimet e tij në ankesë ashtu siç parashihet me nenin 117 par.3 të LZP-së në mënyrë që paneli, të merr vendim në favor të tij.

Nga arsyet e theksuar më e duke bazuar nenin 118 par.1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**  
ZL.Anr.115/2017 më datën 06.10.2017.

**Kryesuesi i Panelit**  
Rafet Haxhaj



***Këshillë Juridik:*** Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa në kuptim të nenit 118 par.4 të LZP-së, mirëpo PZAP-i, mund t'i rishikon cilindo nga vendimet e marra pas prezantimit të fakteve të reja nga pala e interesuar, në afat prej 24 orëve.